PSH.nr.951/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "MATKOS PHARM" SH.P.K – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik Samire Osmani B.I-Leshanë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me material për parandalimin e virusit COVID-19 për nevojat e shkollave të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020-2021" , me nr. të prokurimit: 621-20-5839-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Dragash, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "MATKOS PHARM" SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material për parandalimin e virusit COVID-19 për nevojat e shkollave të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020-2021" , me nr. të prokurimit: 621-20-5839-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Dragash.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material për parandalimin e virusit COVID-19 për nevojat e shkollave të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020-2021" , me nr. të prokurimit: 621-20-5839-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Dragash, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "MATKOS PHARM" SH.P.K –Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "MATKOS PHARM" SH.P.K –Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr. 951/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me material për parandalimin e virusit COVID-19 për nevojat e shkollave të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020-2021" , me nr. të prokurimit: 621-20-5839-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Dragash, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 11.1, 9.1 dhe 9.2, 59, 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar deklaratën nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor të veproj në emër të grupit.

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk gjendet deklarata ku anëtarët e grupit bashkarishtë dhe individualisht deklarojnë që janë përgjegjës e cila është e përcaktuar në Nenit 71 paragrafi 3 i LPP-së,ndërsa sipas RROUP-it ky është kusht administrativ dhe mund të kërkohen sqarime nga OE, andaj eksperti vlerëson se për këtë pikë AK-ja gjatë rivlerësimit të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë.

Paragrafi 3 i Nenit 71 të LPP-së thotë:

Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit

kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.

Neni 39.9 Ii RROUP thotë:

Mungon deklarata **e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund te kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues pretendon qe OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar Nenin 9.1&9.2 të DT-së, Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontrata për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë. OE ka ofruar kontrata dhe referenca jo të natyrës të njejtë si kërkesa e produkteve në tender.

Eksperti shyqrtues konstaton që kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontratë për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit* **të** *njoftimit për kontratë*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

"*Kontrata, lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit, e cila duhet të përmbajë furnizimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës*"

Pas analizimit te dokumentacionit të ofruar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur listën me projektet të realizuar mirëpo duke pas parasysh kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë vetëm kontrata me numër rendor 15 e listuar në listë i përgjigjet Kërkesës së dosjes së tenderit, kontratat tjera të prezantuara shumica janë të natyrës Deratizim, Dezinsektim, Dezinfektim. Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se dëshmitë e ofruar nuk janë konform Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar CE Certifikatë me afat të skaduar për produktin Nr 5 OXIMETER

Eksperti shyqrtues konstaton që kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është: "*Per çdo produkt duhet te kete ISO dhe CE certificate*" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Licenca e*

lëshuar nga AKPPM per qarkullimin me pakice dhe shumice per barna medicinale- (Valide)-Kop"

Pas analizë së dokumentacionit të ofruar eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën me numer 2004016, e cila është e vulosur dhe nënshkruar me 03.04.2020 mirëpo në Certifikatë nuk figuron data e skadencës. Andaj për të sqaruar sa më mirë këtë çështje AK-ja mund të kërkojë sqarime konform Nenit 59 dhe Nenit 72 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon se për produktin Thermometer Certifikata nuk është verifikuar,nëse kyçmi në Ëebsit për verifikimin e CE Certifikatës me këtë numër 2004016 na rezulton tjetër CE certifikatë dhe tjetër model i produktit. Modeli **"EP071407-X"** ndërsa në CE të OE të rekomanduar për kontratë është modeli **"ZLK-IRT 101"**

Duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën e E prokurimit, rrjedhën dhe analizën e procedurës OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur Certifikatën për produktin Thermometer me numër "**2004016**".

Gjatë kërkimit në internet me të njejtin numër rezulton të jetë Thermomenter modeli "**ZLK-IRT 101**" i cili është sipas kërkesës së Neni 2.1 të FDT-së.

Në vijim po u bashkëngjisim me fotografi CE certifikatën me numër "2004016"

Certificate Search		
Certificate No Certification NO	**2004016**	
Authentication type Certification	EMC 2004016	
Applicant Applicant	**Hunan Zhonglankang Medical Technology Co., Ltd.**	
Certified product Product	Infrared Forehead Thermometer	
model Model NO	ZLK-IRT101	
Standard / instruction Standards/Directive	EN 55011:2016 EN 60601-1-2:2015 EN 60601-1: 2006+A1:2013	EN61000-3-2:2014 EN 61000-3-3:2013
Date of issue Date Issued	**2020-04-03**	

ndërsa në vijim po u bashkëngjisim edhe fotografin për të cilën pretendon OE ankues.

Certificate No. DE 2-004016

Certificate Number:	DE 2-004016
Certified Product:	Switch Type Power Supply Model Designation: EP071407-X
Fulfilled Standards:	IEC 60950:1991+A1+A2+A3+A4 The standard(s) listed here reflect the status at the time of the release of this certificate.
Date of Issue:	2001-03-13
	CB-Zertifikat **CB (Certification Body)** Testing of Electrical Products

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se për thermometrin e kërkuar është ofruar dëshmia siç është kërkuar, ndërsa në fotografin e lartcekur vërehet se CE Certifikatë mban numrin **"DE 2-004016"** dhe modeli është "EP071407-X" , që nuk është i njëjte me numrin e certifikatës së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar produktin Nr 1 në katalogun e AK-së është kërkuar Spërkatëse 1000 ml ndërsa i rekomanduari në katalogun e tij ka ofruar Spërkatëse 300 ml.

Eksperti shqyrtues konstaton se në **Nenin 2.1 të FDT-së** është kërkuar Dozer për dezinfektim 1000 ml.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur produktin e kërkuar me përshkrim të detajuar për produktin mirëpo produkti i ofruar nuk është konformë kërkesës 1000 ml por është 300 ml. Shih më posht tabelen me të dhënat e produktit.

DESCRIPTIONS	
Product Code	S7
Description of Product	Liquid Soap, Shampoo and Disinfectant Dispenser
Color	White
Material	ABS
Dimensions (Width x Depth x Height in cm)	6,5 x 10,5 x 20,5 cm
Type	Refill
Liquid Type	Soap / Shampoo / Disinfectant
Liquid Capaticy	300 ml
Dosage Value per Stroke	1,9 ml
Barcode Number	869 742837 078 9

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE "MATKOS PHARM" SH.P.K –Prishtinë të aprovohet pjesërisht si e bazuara, dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 01.12..2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 01.12..2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE "Matkospharm" Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar deklaratën nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor të veproj në emër të grupit.
Paneli Shqyrtues konform sqaron se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk gjendet deklarata ku anëtarët e grupit bashkarishtë dhe individualisht deklarojnë që janë përgjegjës e cila është e përcaktuar në Nenit 71 paragrafi 3 i LPP-së. Ndërsa sipas RROUP-it ky është kusht administrativ dhe mund të kërkohen sqarime nga OE. Andaj, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë. Paragrafi 3 i Nenit 71 të LPP-së thotë:

> *Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.*

Neni 39.9 i RROUP thotë:

Mungon deklarata **e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Mund te kërkohen informata sqaruese	Kusht administrativ

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar nenin 9.1&9.2 të dosjes së tenderit.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontratë për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

"Kontrata, lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit, e cila duhet të përmbajë furnizimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës"

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit te dokumentacionit të ofruar në E prokurim, OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur listën me projektet të realizuar mirëpo duke pas parasysh kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë vetëm kontrata me numër rendor 15 e listuar në listë i përgjigjet Kërkesës së dosjes së tenderit, kontratat tjera të prezantuara shumica janë të natyrës Deratizim, Dezinsektim, Dezinfektim. Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se dëshmitë e ofruar nuk janë konform Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Po ashtu, OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar CE Certifikatë me afat të skaduar për produktin Nr 5 OXIMETER.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "Per çdo produkt duhet te kete ISO dhe CE certificate" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Licenca e lëshuar nga AKPPM per qarkullimin me pakice dhe shumice per barna medicinale-(Valide)-Kop". Për këtë kërkesë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën me numër 2004016, e cila është e vulosur dhe nënshkruar me 03.04.2020 mirëpo në Certifikatë nuk figuron data e skadencës. Andaj për të sqaruar sa më mirë këtë çështje AK-ja mund të kërkojë sqarime konform Nenit 59 dhe Nenit 72 të LPP-së.

OE ankues pretendon se për produktin Thermometer Certifikata nuk është verifikuar, nëse kyçmi në website për verifikimin e CE Certifikatës me këtë numër 2004016 na rezulton tjetër CE certifikatë dhe tjetër model i produktit. Modeli **"EP071407-X"** ndërsa në CE të OE të rekomanduar për kontratë është modeli **"ZLK-IRT 101"**

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur Certifikatën për produktin Thermometer me numër **"2004016"**. Gjatë kërkimit në internet me të njëjtin numër rezulton të jetë Thermomenter modeli **"ZLK-IRT 101"** i cili është sipas kërkesës së Neni 2.1 të FDT-së, ku eksperti ka bashkangjitur certifikatën me numër "2004016" në raport dhe ka bashkangjitur fotografinë për të cilën pretendon OE ankues. Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se për thermometrin e kërkuar është ofruar dëshmia siç është kërkuar, ndërsa në fotografinë e lartcekur vërehet se CE Certifikatë mban numrin **"DE 2-004016"** dhe modeli është "EP071407-X" , që nuk është i njëjte me numrin e certifikatës së ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar produktin Nr. 1 në katalogun e AK-së është kërkuar Spërkatëse 1000 ml ndërsa i rekomanduari në katalogun e tij ka ofruar Spërkatëse 300 ml.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në nenin 2.1 të FDT-së është kërkuar Dozer për dezinfektim 1000 ml. Lidhur me këtë pretendim ankimor, paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur produktin e kërkuar me përshkrim të detajuar për produktin mirëpo produkti i ofruar nuk është konform kërkesës 1000 ml por është 300 ml. Shih më posht tabelen me të dhënat e produktit.

DESCRIPTIONS	
Product Code	S7
Description of Product	Liquid Soap, Shampoo and Disinfectant Dispenser
Color	White
Material	ABS
Dimensions (Width x Depth x Height in cm)	6,5 x 10,5 x 20,5 cm
Type	Refill
Liquid Type	Soap / Shampoo / Disinfectant
Liquid Capaticy	300 ml
Dosage Value per Stroke	1,9 ml
Barcode Number	869 742837 078 9

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së për shkak se OE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për projektet të realizuara dhe sasia e dozerit të kërkuar nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kritereve të cilat i ka përcaktuar në dosje të tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Goran Milenkovic

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK DRAGASH;

1x1 OE – "MATKOS PHARM" SH.P.K –Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.